



Marrëveshja *Pay It Off* (Albanian)

KTHEJENI KONTRATËN TË NËNSHKRUAR TE:

OCSS - Pay It Off
PO Box 830, Canal St. Station
New York, NY 10013

Data:
ID e çështjes:
Prindi jokujdestar:

Shihni nyc.gov/payitoff për mënyra të tjera si ta ktheni. Vendosi telefonin/email-in tuaj:

Kjo marrëveshje është mes jush, _____, dhe Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (Office of Child Support Services) të Administratës së Burimeve Njerëzore (Human Resources Administration) brenda Departamentit të Shërbimeve Sociale të qytetit të Nju-Jorkut (Department of Social Services, NYC DSS). Kjo marrëveshje tregon se ju keni dëshirë të merrni pjesë në programin *Pay It Off të NYC DSS*. Si pjesëmarrës, ju pranoni të paguani \$500 ose më shumë për detyrimet e prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën, të cilat i detyroheni NYC DSS, gjatë periudhës 3 mars 2025 deri më 14 mars 2025. Pagesat tuaja të prapambetura ndaj NYC DSS kanë rezultuar nga një urdhër mbështetjeje nga Gjykata e Çështjeve Familjare dhe/ose Gjykata Supreme e Shtetit të Nju Jorkut që zbatohet përmes Njesisë së Arkëtimit të Detyrimit të Mbështetjes Financiare.

NYC DSS do të pranojë pagesat e bëra nëpërmjet postës, aplikacionit për mbështetjen financiare për fëmijën NYC ACCESS HRA, telefonit, personalisht ose nëpërmjet internetit. Për çdo pagesë të pa-konfiskuar të marrë nga ju gjatë periudhës 3 mars 2025 deri më 14 mars 2025 nëpërmjet çekut të certifikuar ose personal, urdhërpagesës, kartës së kreditit, kartës së debitit Visa/MasterCard, Venmo ose PayPal kundrejt detyrimeve tuaja të prapambetura ndaj NYC DSS, në total \$500 ose më shumë, NYC DSS do të:

- Aplikojë pagesën tuaj (minimumi \$500) në llogarinë tuaj të mbështetjes financiare për fëmijën dollar për dollar (deri në shumën që detyroheni) për të zvogëluar shumën që i detyroheni NYC DSS;
- Nëse zbatohet, do të ulë borxhin tuaj të caktuar në mënyrë të përhershme për mbështetjen financiare për fëmijën të NYC DSS deri në njëzet e pesëqind dollarë shtesë (\$2,500), sepse jeni regjistruar gjithashtu në *Programin e Kreditit të Detyrimeve të Prapambetura (Arrears Credit Program)*; dhe
- Nëse zbatohet, do të eliminojë interesin e gjykitimit të parave që i detyroheni NYC DSS sepse e keni paguar plotësisht principalin e gjykitimit. Ne do t'ju tregojmë me shkrim se sa interes është hequr.

Jam dakord që NYC DSS mund të aplikojë çdo mbipagesë për të kredituar borxhin e DSS në llogaritë e tjera të mbështetjes financiare për fëmijën që mund të kem.

Ky dokument tregon të gjithë marrëveshjen ndërmjet palëve dhe nuk mund të modifikohet, ndryshohet ose anulohet, përveçse me shkrim i nënshkruar nga ose në emër të palëve.

Pagesat e mbledhura nëpërmjet një konfiskimi (duke përfshirë konfiskimet e pagave dhe të sigurimit për papunësi), sequestrimit, rimbursimit të taksave ose mjeteve të tjera administrative të zbatimit të detyrueshëm nuk do të rakordohen përmes *Pay It Off*. Pagesat e bëra sipas kësaj marrëveshjeje nuk heqin në vetvete asnjë urdhër për pagesë të prapambetur. Vetëm gjykata mund ta heqë urdhrin.

Duke nënshkruar këtë marrëveshje, ju kuptoni kërkesat me të cilat po bini dakord dhe që NYC DSS ka verifikuar identitetin tuaj.

Marrëveshjet duhet të përfshijnë një kopje të një identifikimi të vlefshëm me fotografi të lëshuar nga qeveria.

Prindi jo-kujdestar

Përfaqësues i Autorizuar i NYC DSS

A keni ndonjë problem shëndetësor ose problem me shëndetin mendor apo aftësi të kufizuara? A e keni të vështirë për shkak të këtij problemi të kuptoni atë çfarë thuhet në njoftim apo të bëni atë që ju kërkohet? A jua vështirëson kjo gjendje përfitimin e shërbimeve të tjera në HRA? **Ne mund t'ju ndihmojmë.** Na telefononi në numrin 718-557-1399. Gjithashtu, ju mund të kërkoni ndihmë duke u paraqitur pranë një zyre të HRA-së. Ju gëzoni të drejtën ta kërkoni këtë lloj ndihme në përputhje me ligjin.